
JETA SHKENCORE

**KONFERENCË SHKENCORE KUSHTUAR
65-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË SHQIPËRISË
Tiranë, 26 nëntor 2009**

Instituti i Historisë, në Qendrën e Studimeve Albanologjike, organizoi në Tiranë konferencën shkencore “Shqipëria në Luftën e Dytë Botërore”. Ajo i zhvilloi punimet më 26 nëntor 2009 në kuadrin e 65-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë nga pushtuesit nazifashistë.

Konferenca i zhvilloi punimet në sallën e Akademisë së Shkencave me pjesëmarrjen e studiuesve të shkencave albanologjike, studentëve dhe të veteranëve, pjesëmarrës në Luftën e Dytë Botërore. Punimet e konferencës i hapi zv.drejtori i Qendrës së Studimeve Albanologjike njëherësh dhe drejtori i Institutit të Historisë, akademik Beqir Meta.

Gjatë fjalës së tij, akademik Beqir Meta evokoi këtë periudhë të historisë së shqiptarëve ku spikati pjesëmarrja e tyre në përputhje me potencialet ekonomike ushtarake e njerëzore në konfliktin botëror të viteve 1939-1945.

Ai u kujtoi pjesëmarrësve se studimet rreth kësaj periudhe historike duhen thelluar më tej për dy arsye themelore. Së pari, sepse studimet e mëparshme, gjatë kohës së diktaturës komuniste, kanë qenë nën trysinë ideologjike dhe politike të partisë shtet, gjë që ka reflektuar subjektivizëm dhe njëanshmëri tek studimet e shkrimet për Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri.

Së dyti, sepse mundësitë e konsultimit të dokumenteve të pashfrytëzuara më parë si dhe të mjaft burimeve historiografike të autorëve të huaj mbi këtë periudhë historike, krijojnë nevojën e thellimit të studimeve të kësaj periudhe, për të plotësuar një kuadër më të gjerë të realitetit historik të ngjarjeve e proceseve historike gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

Më tej akademik Beqir Meta shprehu besimin e tij se kumtesat e përgatitura për këtë veprimtari shkencore do të synojnë të përmbushin detyrën për thellimin e studimeve historike për këtë ngjarje që e rreshtoi Shqipërinë në radhën e fitores antifashiste.

Prof. Dr. Muharrem Dezhgiu paraqiti kumtesën “Ideja dhe realizimi i Frontit Antifashist në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore”.

Autori parashtrroi kushtet dhe rrethanat historike të kohës në të cilat u shtrua domosdoshmëria e bashkimit të shqiptarëve për përballimin e rezistencës kundër pushtimit nazifashist të vendit në vitet 1939-1944. Pastaj u ndal në tre momente të favorshme që duheshin shfrytëzuar nga shqiptarët për të realizuar bashkimin e tyre në një front të përbashkët antifashist.

Ai e konsideroi si një premisë të fuqishme qëndrimin e Mbretit Zog për të mos abdukuar përballë kërcënimeve të pareshtura të Italisë. Pozicioni antifashist i A. Zogut gjatë gjithë luftës, mund të shërbente si një mbështetje e fuqishme për organizimin e qëndresës antifashiste brenda vendit dhe për koordinimin me qëndresën nga jashtë.

Më tej autori i referohet Konferencës së Pezës si një moment i rëndësishëm, ku u shpalos ndërgjegja politike e klasës politike shqiptare, me vullnetin për të hedhur bazat për një bashkëpunim. Në atë konferencë, thekson autori, lindi një Lëvizje Nacionalçlirimtare por nuk u arrit të krijohet një Front Antifashist që të bashkonte të gjithë shqiptarët “pa dallim krahine, feje e ideje”. Konferenca e Pezës ishte një përpjekje për bashkim në luftë, konceptuar sipas stilit dhe objektivave komuniste.

Autori argumentoi pikëpamjen e tij se kushtet objektive dhe optimale për krijimin e Frontit Antifashist të vërtetë u krijuan në verë të vitit 1943. Për këtë ai u referohet fakteve që e bënë të mundshme një gjë të tillë. Forcat politike shqiptare të organizuara njihnin peshën e njëra-tjetrës, vlerësonin bashkëpunimin midis tyre dhe në mjaft krahina të vendit kishin arritur në marrëveshje. Edhe pushtuesi e shpallte hapur se, në verë të vitit 1943, ai ndodhej përballë një “fronti unik antiitalian” në Shqipëri.

Autori e konsideron Mbledhjen e Mukjes një ngjarje të rëndësishme historike, për faktin se nga kjo mbledhje doli “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë”, të cilën autori e cilëson si organin më të lartë të bashkimit të shqiptarëve në një Front Antifashist dhe që i përfshinte ato në luftë pa dallim bindjeje politike. Pushtuesi e cilëson rezultatit e Mbledhjes së Mukjes “një bashkim kombëtar që kishte si program përzënien e italianëve nga Shqipëria”.

Më tej autori analizoi shkaqet dhe pasojat e prishjes së Marrëveshjes së Mukjes nga Partia Komuniste e Shqipërisë, ku pasoja më e rrezikshme ishte minimi i bashkimit të shqiptarëve dhe imponimi i luftës civile midis tyre, për çështjen e marrjes së pushtetit politik që gjatë luftës.

Fronti Nacionalçlirimtar, i krijuar dhe i drejtuar nga PKSH, mbeti si një maskë e kësaj të fundit dhe nuk realizoi bashkimin e të gjithë shqiptarëve.

Prof. dr. Xhelal Gjeçovi lexoi kumtesën “*Refleksione mbi Luftën e Dytë Botërore në Shqipëri*”. Midis të tjerave ai trajtoi raportet e ndërhyrjes së politikës ndaj studimeve historike, duke shtruar nevojën e mënjanimin të kësaj ndërhyrjeje .

Ai vuri në dukje se liria akademike e shkrimit të historisë ka krijuar mundësinë e rrahjes së problemeve nga këndvështrime të ndryshme gjë që bëri të mundur jo vetëm të shkohet më me siguri drejt të vërtetës historike objektivisht. Autori theksoi se monopolin e të vërtetës historike nuk mund ta ketë asnjë autor i veçantë. Ndaj, sipas autorit, në studimin e problemeve të ndryshme historike ka vend për mendimin e fjalën e të gjithëve. Me këtë rast ai pohoi se kjo tolerancë dhe ky respekt ndaj fjalës dhe mendimit të kolegut ka krijuar një hapësirë të gjerë të veprimtarisë dhe të punës së historianëve. Gjithashtu autori iu referua disa fakteve historike, të shfrytëzuara prej vitesh nga historiografia e mëparshme, për të treguar përmasat e pjesëmarrjes së shqiptarëve në këtë luftë, që duhen parë me rezerva dhe duhen verifikuar duke shfrytëzuar të gjithë shumëllojshmërinë e burimeve dokumentare që janë hedhur tashmë në qarkullimin shkencor.

Akademik Beqir Meta mbajti kumtesën “*Qëndrimi i qeverive greke ndaj rezistencës antifashiste të popullit shqiptar*”. Midis të tjerave, autori argumentoi me dokumente të shumta faktin se “qëndrimi i qeverive greke ndaj rezistencës shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, përshkohet nga një bosht nacionalist shoven dhe në qendër të politikës së tyre ka qenë objektivi i pandryshuar për të aneksuar Shqipërinë e Jugut. Ky objektivi, konkludoi autori, mbeti konstant në të gjitha fazat e luftës ndonëse lëvizjet taktike të politikës greke u përshtatën me rrethanat e ndryshme të saj.

Më tej autori zbulon arsyet e këtij qëndrimi armiqësor dhe jo bashkëpunues të politikës greke me shqiptarët. Presioni grek mbi politikën britanike bëri që Londra të mbante në karantinë Zogun, të vononte për një farë kohe nxjerrjen e deklaratës britanike për Shqipërinë. Qeveria greke u përpoq të ushtronte presion edhe ndaj qeverisë amerikane por pa sukses. Qeveria greke në mërgim u përpoq të bënte negativimin e rezistencës së brendshme antifashiste në Shqipëri, kur ajo po rritej në kundërshtim me dëshirën greke. Qeveria greke përsëriti protestat ndaj BBS-së, e cila transmetonte informacione për luftën antifashiste në Shqipëri etj. Qeveria greke, thekson autori, arriti deri atje që, më 15 gusht 1944, kur luftës po i vinte fundi, t'i kërkonte Departamentit të Shtetit Amerikan të miratonte okupimin e Shqipërisë së Jugut nga trupat greke deri në Shkumbin.

Së fundi, autori arrin në përfundimin se popujt shqiptar e grek edhe pse ishin viktima të një lufte të paprovokuar prej tyre nuk arritën të vendosnin marrëdhënie miqësore të fqinjësisë së mirë. Pengesa kryesore për arritjen e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit u bë politika nacionaliste ekstreme dhe jo realiste e qeverisë greke dhe e forcave të djathta greke ndaj Shqipërisë. Greqia, me insistimin e saj arriti të ndikojë mbi politikën e Fuqive Perëndimore për të bllokuar njohjen e qeverisë së ligjshme shqiptare në ekzil, duke e lënë popullin shqiptar pa një përfaqësi zyrtare jashtë vendit, e cila duhej të mbronte interesat e tij.

Prof. asoc. dr. Hamit Kaba lexoi kumtesën “*Relacione shqiptaro-amerikane (1939-1945)*”. Pasi bëri një pasqyrë të shkurtër të studimeve për marrëdhëniet shqiptaro-amerikane, vuri në dukje se gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk ka pasur bashkëpunim në nivelin shtetëror dhe diplomatik midis Shqipërisë dhe SHBA.

Bashkëpunimi shqiptaro-amerikan u ndërpre pas pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste. Këtë pushtim qeveria amerikane nuk e njohu dhe e dënoi nëpërmjet deklaratës së Sekretarit të Shtetit, të datës 8 prill 1939. Edhe pas miratimit të ligjit amerikan për “Neutralitetin” qeveria amerikane nuk u pengua për të dënuar pushtimet e shteteve të Aksit fashist.

Autori e trajton qëndrimin e qeverisë amerikane ndaj Shqipërisë, në kuadrin më të gjerë të marrëdhënieve ndërkombëtare, të mbështetura në faktorë që peshonin në sjelljet dhe qëndrimet e tyre ndaj pushtimit të Shqipërisë.

Duke trajtuar relacionet e SHBA ndaj rezistencës shqiptare autori bën objekt deklaratën e qeverisë amerikane të dhjetorit 1942 për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, për ardhjen e misionit amerikan në Shqipëri, për qëndrimin ndaj Mbretit Zog dhe të gjithë kërkesave të vazhdueshme të personaliteteve të spikatura politike shqiptare. Lidhur me njohjen e Mbretit Zog, autori pohon se, qeveria amerikane i përmbahej politikës së mospërfshirjes në punët e brendshme të vendeve të tjera. Megjithatë, qeveria amerikane nuk ishte dakord me vendimin e Kongresit të Përmetit që ndalonte kthimin e Zogut në Shqipëri. Karta e Zogut nuk u hodh poshtë nga qeveria amerikane, por u ruajt si rezervë e cila mund të aktivizohej në të ardhmen, pasi nuk besohej tek shanset qeverisëse të komunistëve shqiptarë.

Në trajtesë zë vend dhe çështja e përfundimit pa sukses të Misionit të SHBA në Shqipëri më 1946, i cili lidhet jo vetëm me qëndrimet orientuese dhe urdhëruese të qeverive jugosllave e sovjetike ndaj Shqipërisë, por edhe me situatën e tendosur ndërkombëtare, si rezultat i fillimit të Luftës së Ftohtë.

Prof. dr. Ana Lalaj mbajti kumtesën “*Shqipëria në projektet për Federatën Ballkanike*”. Autorja, pasi vuri në dukje faktin se koncepti federatës multinacionale imponohej nga siguria nacionale, historikisht e rrezikuar e shteteve të vegjël të Europës Juglindore, tregoi hapat në vijim të kësaj politike që u hodhën në vitin 1941. Aso kohe qeveria britanike organizoi një varg takimesh me përfaqësuesit e qeverive legjitime të vendeve të Europës Juglindore.

Në këtë kontekst ka trajtuar autorja qëndrimin ndaj Mbretit Zog për t’u njohur me statusin e tij sikurse homologët e vendeve fqinje, që dhe Shqipëria të përfaqësohej si subjekt ndërkombëtar në të gjitha projektet që konvergonin në rezultatet e Luftës Botërore.

Më tej në kumtesë trajtohen reagimet sovjetike ndaj propozimeve britanike për konfederatat e Europës Juglindore, të cilat konsideroheshin si krijesa artificiale dhe se disa nga këto plane për federatat, i kujtonin popullit sovjetik politikën e “Kordonit sanitar”.

Ndërkohë që ishin mbyllur kombinacionet për federatat në Evropën Juglindore, në Ballkan kishte filluar të fermentohej një tjetër lëvizje federaliste për t’i dhënë Jugosllavisë një vend udhëheqës në Ballkan. Në këtë kontekst trajtohet dhe Mbledhja e Dytë e AVNOJ-t në 29 nëntor 1943, që realizoi ngrehinën e Federatës Jugosllave. Departamenti i Shtetit e konsideroi këtë krijesë një faktor destabilizimi në Evropën Juglindore, sepse shtetet joslave do ta shikonin atë si një kërcënim të sigurisë së tyre. Përfshirja e Shqipërisë në Federatën Ballkanike do të varej nga platforma jugosllave, e cila ishte shumë më e prirur ndaj një federate, më parë me Shqipërinë, se sa me Bullgarinë.

Dr. Vasfi Baruti mbajti kumtesën “*28 Nëntori i tretë i Shqipërisë*”. Autori solli dokumente bindëse për të vërtetuar shkencërisht se çlirimi i Shqipërisë më 28 Nëntor 1944, bëri të mundur që shqiptarët, nga kjo kohë do ta kishin këtë datë, 28 Nëntor një festë të trefishtë që do t’u kujtonte vite të ndryshme (1443, 1912, 1944) por në thelb një trashëgimi historike – luftën e shqiptarëve për pavarësi e liri kombëtare. Autori vë në dukje se çlirimi i Shqipërisë ishte një realitet historik para 28 Nëntorit duke iu referuar fakteve: se ishte çliruar kryeqyteti më 17 nëntor 1944, se nga 20 deri 27 nëntor nuk shënjohej as edhe një goditje e vogël kundër garnizonit të vogël gjerman që mbante Shkodrën, ndërkohë që nga tetori brigadat partizane kishin shkuar në Kosovë dhe në tokën jugosllave.

Autori përmend si argument themelor për 28 Nëntorin, si dita e Çlirimit, faktin se në këtë ditë u bënë festimet në Tiranë për çlirimin e Shqipërisë. Përgatitjet për festën që nga Berati më 27 nëntor dhe deri në Tiranë, me jehonën ndërkombëtare që patën këto festime që shënonin çlirimin e Shqipërisë. Deklarata e udhëheqësit të “fitimtarëve” Enver Hoxha deklaronte hapur e qartë para popullit nga tribuna e festës se, “Dita e Flamurit” u bë dita dy herë e shenjtë, dita e çlirimit dhe e bashkimit të popullit shqiptar, ishte fakt i pakundërshtueshëm për argumentin në fjalë.

Autori trajtoi qartë dhe të gjitha përpjekjet dhe qëllimet e politikës për ta falsifikuar e ndryshuar vendimin e Kryesisë së Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të 5 Nëntorit 1945, që kishte vendosur zyrtarisht që, 28 Nëntori 1944 të kremtohej si festë e çlirimit të Shqipërisë. Më në fund autori arsyetoi me argumente se ndryshimi i ditës së çlirimit nga 28 Nëntor më 29 Nëntor 1944, ishte një vendim politik, që i referohet ndërhyrjes së emisarëve jugosllavë tek Enver Hoxha, që 29 Nëntori të ishte festë e

përbashkët e të dy vendeve. Kumtesa mbyllet me një letër të E. Hoxhës drejtuar Titos, më 17 mars 1948, për bashkimin e Shqipërisë me Jugosllavinë e cila, sipas autorit, e bën E. Hoxhën të ishte flamurtari i bashkimit të Shqipërisë me Jugosllavinë e Titos.

Ma. Marenglen Kasmi mbajti kumtesën “*Historiografia gjermane për pushtimin gjerman në Shqipëri*”. Duke bërë një përmbledhje të botimeve gjermane që trajtojnë këtë periudhë historike, autori citon nga këto burime historiografike të dhëna me interes për sa i përket forcave gjermane në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore, por edhe për qëllimet strategjike që kishte Gjermania në Shqipëri duke zbatuar politikën e “pavarësisë relative” apo “sovrانيتin relativ” që lidhej me situatën e marrëdhënieve ndërkombëtare gjatë Luftës Botërore.

Ai vuri në dukje se të dhënat që sillen nga historiografia gjermane na japin mundësinë të verifikojmë e të ballafaqojmë mjaft nga burimet tona të brendshme, për të saktësuar mjaft probleme të trajtimit të historisë së shqiptarëve në vitet e Luftës së Dytë Botërore.

Rreth kumtesave pati dhe diskutime nga pjesëmarrësit e Konferencës, duke i mbështetur apo duke i plotësuar ato trajtime që u bënë objekt në Konferencë.

Drejtori i Institutit të Historisë akademik Beqir Meta, në mbyllje të Konferencës përgëzoi referuesit për trajtesat e tyre me kompetencë shkencore dhe për mundësitë e shumta që na hapen, për të nxjerrë në pah sa më mirë dhe sa më të plotë rolin e rezistencës shqiptare në Luftën e Dytë Botërore si dhe rrjedhojat që pati ajo në ngjarjet e mëvonshme të procesit historik të Shqipërisë së pasluftës.

Muharrem DEZHGIU